




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

ANKETA E MBETURINAVE TË TRAJTUARA 2022



AGJENCIA E STATIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Prishtinë, 2023

Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)
Data e botimit: Tetor, 2023
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara (AMT) për vitin referues 2022, si anketë e rregullt vjetore. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të sigurohen të dhëna të qëndrueshme statistikore për sektorin e mbeturinave në Kosovë.

Rezultatet e paraqitura në këtë publikim ofrojnë burim të rëndësishëm statistikor të gjendjes aktuale të këtij sektori. Metodologjia e përdorur për realizimin e anketës së lartpërmendur është në përputhje me Ligjin për Mbeturinat në Kosovë (Nr. 02/L-30 dhe Nr.04/L-60), si dhe me rregulloret dhe rekomandimet e BE-së.

Falënderimet i dedikohen ekspertit nga GOPA, Volker Küchen (ARGUS GmbH, Berlin) për mbështetje profesionale.

Publikimin përgatiten:

Bajrush Qevani - Drejtor DSBM
Haki Kurti, MSc - Shef i Divizionit të Statistikave të Mjedisit
Flutura Shosholli - Zyrtare e Statistikave të Mjedisit
Ismet Ahmeti - Zyrtar i Statistikave të Mjedisit
Drita Sylejmani - Zyrtare e Disiminimit

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dergoni në adresën e ueb faqes infoask@rks-gov.net

Tetor, 2023

Zv. Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së
Ilir T. Berisha

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
AMT	-	Anketa e Mbeturinave të Trajtuara
LoW	-	Lista e Mbeturinave
NACE Rev.2	-	Klasifikimi i Aktiviteteve Ekonomike
EWStat.		
Classification	-	Katalogu Evropian i Mbeturinave
DS	-	Deponitë Sanitare
Kg	-	Kilogram
T	-	Ton
%	-	Përqindje

Përmbajtja

	Faqe
1.Shpjegime metodologjike	5
1.Informacion i përgjithshëm	5
2.Objektivat dhe metodologjia	5
2.1. Objektivi.....	5
2.2.1 Korniza e anketës	5
3.Definicionet.....	6
4.Rezultatet.....	7

Shpjegime Metodologjike

1. Informacione të përgjithshme

Anketa e Mbeturinave të Trajtuar (AMT) në Kosovë u realizua sipas NACE Rev.2, që njëkohësisht është dhe klasifikim statistikor i aktiviteteve ekonomike. Gjithashtu AMT 2022 është realizuar bazuar në Ligjit për Mbeturina në Kosovë, Nr. 04 / L-060 dhe ne përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 nëntorit 2002 mbi statistikat e mbeturinave.

2. Objektivat dhe metodologjia e anketës

2.1. Objektivi

Objektivi i Anketës së Mbeturinave të Trajtuar 2022 ishte që të sigurojë informacion mbi statistikat e mbeturinave sipas kategorive, si vijon:

- Sasinë e mbeturinave të deponuara
- Sasinë e mbeturinave të ricikluar dhe
- Sasinë e mbeturinave të sterilizuara

AMT 2022, ka për qëllim: grumbullimin e të dhënave statistike nga bizneset, që merren me trajtimin e mbeturinave (deponitë regjionale, objektet e trajtimit të mbetjeve spitalore, sterilizimi), sigurimin e të dhënave të qëndrueshme statistike për sektorin e mbeturinave dhe krijimin e serisë kohore për mbeturinat e trajtuara.

Gjithashtu, me publikimin e AMT 2022, janë përmbushur kërkesat e shfrytëzuesve për statistikat e mbeturinave të trajtuara në nivel vendi.

2.2. Metodologjia

2.2.1. Korniza e anketës

Metodologjia për realizimin e anketës në terren është përgatitur gjatë periudhës Maj - Qershor 2022. Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dokumentet si vijon: pyetësi dhe udhëzuesi për intervistuesit dhe mostra e anketës. Mostra është nxjerrë nga regjistri i biznesit në ASK.

Në këtë anketë janë përfshirë bizneset të cilat merren me trajtim të mbeturinave. Bizneset aktivitetet e të cilëve kufizohen në mbledhjen dhe tregtimin e mbeturinave të riciklueshme (bizneset që i përkasin E38 dhe G46.77), në AMT 2022 nuk janë përfshirë.

Mbledhja e të dhënave është kryer gjatë muajit Gusht-Shtator 2023, ndërsa intervistat me biznese janë realizuar sipas metodës tradicionale "ballë për ballë".

Trajnimi njëditor është mbajtur në ASK për të gjithë anketuesit. Mostra e AMT 2022 është përbërë prej 96 bizneseve.

2.1.2 Mbledhja e të dhënave

Puna në terren është realizuar gjatë periudhës kohore Gusht-Shtator 2023, nga anketuesit e zgjedhur sipas Vendimit të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve. masa 1.4 - Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, për punë praktike në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Gjithashtu gjatë periudhës së lartpërmendur nga stafi i ASK-së, është realizuar mbikëqyrja dhe kontrollimi cilësor dhe sasior i pyetësorëve të plotësuar në terren nga anketuesit.

3. Definicionet

Trajtimi i mbeturinave - Nënkupton procesin fizik, kimik, biologjik, termal, duke përfshi edhe ndarjen e mbeturinave në lloje, me qëllim të pakësimit të vëllimit dhe karakteristikave të dëmshme të mbeturinave, si dhe lehtësimin për manipulim me mbeturina ose riciklimin e tyre.

Riciklimi - Çdo operim me qëllim të përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substanca qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshinë rikthimin e materialeve organike por nuk përfshinë përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave.

Impiant - Objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar.

Deponi - Vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

Mbeturinat medicinale Mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale.

Sterilizim- Asgjësim i plotë i të gjitha mikroorganizmave dhe sporeve përkatëse në produktet ushqimore, përgatesat farmaceutike, instrumentet kirurgjike, materialet lidhëse etj. Sterilizimi përgjithësisht kryhet me mjete fizike, prej të cilave më shpesh përdoret nxehtësia (#120°C).

Realizohet me anë të ujit të vëluar, përpunimit me avuj uji nën tryzni në autoklavë, me ajër të thatë në dollapë tharës (termostat) etj. Mjete të tjera fizike janë rrezet ultravjollcë, infra të kuqe, filtrimi sterilizues etj.

4. Rezultatet e Anketës së Mbeturinave të Trajtuara 2022

Tabela më poshtë tregon sasinë e mbeturinave të ricikluara, të sterilizuara (në impiantet adekuate për sterilizim), të deponuara dhe gjithsej sasinë e mbeturinave të trajtuara në vitin 2022.

Tabela 1: Mbeturinat e trajtuara sipas llojit për vitin 2022/t


Mbeturina	Deponuara	Ricikluara	Sterilizuara	Gjithsej
Mbeturina spitalore	:	:	1 245	1 245
Mbeturina të letrës dhe kartonit	:	10 839	:	10 839
Mbeturina nga metali	:	3 524	:	3 524
Mbeturina nga plastika	:	8 519	:	8 519
Mbeturina nga ekonomitë familjare dhe të ngjashme	497 045	:	:	497 045
Gjithsej	497 045	22 882	1 245	521 172

Të dhënat në tabelën 1, tregojnë se gjithsej sasia e mbeturinave të ricikluara ka qenë 22 882 ton, sasia e mbeturinave të sterilizuara (mbeturina medicinale) ka qenë 1 245, ton. Ndërsa gjithsej sasia e mbeturinave të trajtuara dhe të deponuara në vitin 2022 ishte 521 172 ton., krahasuar me të dhënat e vitit 2021, ka një rritje prej 3.0 %.

Sasia e mbeturinave të trajtuara, sipas llojit të mbeturinave dhe llojit të trajtimit, e shprehur në përqindje për vitin 2022 ishte si vijon:

- Mbeturina nga plastika 35%
- Mbeturina nga metalet 15%
- Mbeturina medicinale-spitalore 5%
- Mbeturina nga letra dhe kartoni 45%

Figura 1: Struktura e mbeturinave të trajtuara sipas llojit të trajtimit 2022 (%)




1) Në kategorinë mbeturina të sterilizuara janë përfshirë të dhënat e mbeturinave medicinale-spitalore nga institucionet shëndetësore; Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), si dhe nga spitalet regjionale të Kosovës (Gjilan, Prizren, Gjakovë Ferizaj, Pejë, Vushtrri dhe Mitrovicë).

Tabela 2: Të dhënat e mbeturinave të grumbulluara në deponitë e licencuara për vitin 2022/t

Deponitë	Gjithsej/ton	%
DS-Prishtinë	168 395	33,9
ST-Ferizaj	28 612	5,8
DS-Gjilan	43 242	8,7
DS-Mitrovicë	52 858	10,6
DS-Pejë	57 655	11,6
DS-Prizren	128 832	25,9
DS-Podujevë	17 451	3,5
Gjithsej	497 045	100

Nga të dhënat në tabelën 2 vërehet se sasia e mbeturinave të deponuara në vitin 2022 ka qenë 497 045 /t, krahasuar me të dhënat e vitit 2021, ka një rritje prej 2.74 %, ndërsa krahasuar sipas regjioneve sasia më madhe e mbeturinave të deponuara ka qenë në deponin sanitarë në regjionin e Prishtinës (Mirash), 168 395/t ose 33.9%.

Figura 2: Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara, 2022 (%)



Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

628.54:311(496.51)”2022”

Anketa e Mbeturinave të Trajtuar : 2022 / publikimin përgatiten Bajrush Qevani ...
[etj.]. - Botim elektronik. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2023. - 1
burim elektronik (14 f.) : ilustr. ; 28 cm. - (Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit Seria ;
2)

1. Qevani, Bajrush 2. Kurti, Haki 3. Shosholli, Flutura 4. Ahmeti, Ismet

ISBN 978-9951-30-004-9

Agjencia e Statistikave te Kosovës: Përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukture organizative: Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj.

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41 Agjencioni ka këtë strukture kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikat e shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomive Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni: +383 (0) 38 200 31 129

Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112

Fax: +383 (0) 38 235 033

E-mail: infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net>

ISBN 978-9951-30-004-9



9 789951 300049